

NJOFTIM PËR MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës njofton opinionin publik se është duke kryer analizë të regjimit të sapovendosur për shfrytëzimin e zonës „Hug & Fly“ në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, me të cilin qëndrimi falas deri në 10 minuta është i kufizuar në vetëm një hyrje me të njëjtin automjet në një periudhë prej 24 orësh.

Analiza do të ketë për qëllim të vërtetojë nëse regjimi i vendosur, duke marrë parasysh kushtet në të cilat veprojnë transportuesit e ndryshëm taksi dhe ekzistencën e një operatori taksi të autorizuar posaçërisht nga aeroporti, mund të ndikojë në kushtet e konkurrencës dhe në qasjen në infrastrukturën e aeroportit.

Komisioni do të shqyrtojë arsyeshmërinë dhe proporcionalitetin e kushteve të vendosura, ndikimin e tyre faktik te transportuesit taksi dhe nëse ekzistojnë kushte të barabarta dhe jodiskriminuese të qasjes për të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Në këtë fazë, Komisioni nuk paragjykon ekzistencën e ndonjë shkeljeje të rregullave të konkurrencës. Pas mbledhjes dhe analizimit të të gjitha informacioneve përkatëse, Komisioni do të nxjerrë një konkluzion përkatës për veprimet e mëtejshme.

Komisioni mbetet i përkushtuar në sigurimin e kushteve të barabarta për konkurrencë dhe në parandalimin e çdo sjelljeje që mund të çojë në kufizimin ose cenimin e konkurrencës në treg.